


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Shtator, 2018

Tiranë, më 08 Tetor 2018: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Shtator 2018, arriti 105,2 kundrejt muajit Dhjetor 2015.


Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Shtator 2018 është 2,1 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,6 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Shtator 2018, krahasuar me Gusht 2018, është 0,2 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin Shtator është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,03 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me +0,58 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” kanë kontribuar me +0,14 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,06 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Komunikimi” dhe “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Shërbimi arsimor” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Shëndeti” kanë kontribuar me -0,01 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Shtator 2017, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 5,2 %, pasuar nga grupet “Transporti” me 3,2 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 2,8 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,6 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,7 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,0 %, “Komunikimi” me 0,7 %, “Veshje dhe këpucë” me 0,6 %, “Shërbimi arsimor” me 0,5 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 14,6 %, pasuar nga nëngrupet “fruta” me 3,8 %, “vajra dhe yndyrna me 2,2 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 1,2 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” u ulën me 1,2 %.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Gusht 2018 rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 2,0 %, ndikuar kryesisht nga ndryshimi i çmimeve të teksteve shkollorë¹. Rritje patën dhe grupet “Veshje dhe këpucë” me 0,6 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,3 %, “Transporti” me 0,2 %, etj. Ndërsa, çmimet e grupeve “Pije alkoolike dhe duhan”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” shënuan një ulje prej 0,1 % secili.

¹ Janë përjashtuar nga llogaritja tekstet shkollorë të ciklit të ulët (klasa I-IV) të cilat jepen falas.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	09-17	10-17	11-17	12-17	01-18	02-18	03-18	04-18	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18
	Gjithsej	100	103,1	103,1	103,0	104,0	105,6	106,4	106,7	106,2	104,9	104,9	104,6	105,0	105,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	38,6	106,7	106,5	105,7	107,5	110,8	113,1	114,1	112,5	109,2	108,8	108,2	109,1	109,5
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,5	101,6	101,5	101,7	101,8	102,9	103,0	103,6	103,6	103,3	103,4	103,4	103,4	103,3
3	Veshje dhe këpucë	4,1	98,3	99,9	100,2	101,5	101,0	100,4	99,5	99,3	98,5	99,0	98,5	98,4	98,9
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,9	101,5	101,6	102,0	103,1	104,4	104,4	104,0	104,1	104,1	104,3	104,2	104,3	104,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,1	99,4	99,5	99,7	100,2	100,1	100,3	100,2	99,9	99,9	99,7	99,2	99,3	99,5
6	Shëndeti	3,0	100,0	100,0	100,4	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,4	99,9	99,6	99,6	99,6
7	Transporti	6,0	100,3	100,0	101,3	101,2	101,2	101,1	101,2	101,4	101,8	102,4	103,0	103,3	103,5
8	Komunikimi	2,8	100,4	100,4	100,7	100,8	100,8	101,2	101,3	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	102,5	103,3	101,8	102,3	102,4	102,8	103,9	105,6	105,8	105,8	105,2	105,7	107,8
10	Shërbimi arsimor	3,1	100,9	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,4
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,8	100,1	100,1	100,2	100,6	100,7	100,8	100,9	101,0	101,0	101,0	101,2	101,2	101,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	103,4	103,4	103,4	103,5	103,6	103,6	103,7	103,8	103,7	103,7	103,6	103,6	103,6

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	09-17/09-16	10-17/10-16	11-17/11-16	12-17/12-16	01-18/01-17	02-18/02-17	03-18/3-17	04-18/04-17	05-18/05-17	06-18/06-17	07-18/07-17	08-18/08-17	09-18/09-18
	Gjithsej	1,6	1,9	1,7	1,8	1,7	2,1	2,0	2,1	2,1	2,4	2,3	2,2	2,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,5	4,0	3,7	2,8	2,2	2,7	3,1	3,1	2,8	3,2	3,0	2,8	2,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,6	0,4	0,9	0,5	1,5	1,6	1,9	1,7	1,6	1,6	1,7	1,8	1,7
3	Veshje dhe këpucë	-1,6	-0,4	-0,4	0,6	1,1	2,9	1,8	3,4	2,2	3,3	2,3	2,4	0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,1	1,1	0,6	2,2	3,3	3,1	2,2	2,5	2,7	2,9	2,8	2,8	2,8
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,8	-0,2	-0,5	0,0	-0,2	0,2	0,2	0,0	0,0	-0,1	-0,3	-0,2	0,0
6	Shëndeti	-0,2	0,0	0,2	0,1	0,1	0,1	0,0	0,2	0,2	-0,2	-0,5	-0,4	-0,4
7	Transporti	0,8	0,4	1,9	2,1	1,8	2,3	1,3	1,0	2,1	3,1	3,2	3,0	3,2
8	Komunikimi	-0,1	0,0	0,0	0,2	0,6	1,0	1,0	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,7
9	Argëtim dhe kulturë	0,8	2,1	0,8	-0,1	-0,8	-0,2	0,5	0,8	3,5	4,2	4,6	5,3	5,2
10	Shërbimi arsimor	1,0	0,9	0,5	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,1	0,0	0,2	0,5	0,7	0,7	0,7	0,9	0,9	0,9	1,1	1,1	1,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,2	0,3	0,2	0,3	0,4	0,2	0,5	0,3	0,3	0,2	0,2	0,1

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	09-17	10-17	11-17	12-17	01-18	02-18	03-18	04-18	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18
	Gjithsej	0,4	0,04	-0,1	1,0	1,5	0,8	0,3	-0,5	-1,2	-0,1	-0,3	0,4	0,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	0,5	-0,1	-0,8	1,8	3,1	2,0	0,9	-1,4	-3,0	-0,3	-0,5	0,8	0,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,0	0,0	0,2	0,1	1,1	0,1	0,6	0,0	-0,3	0,1	0,0	0,0	-0,1
3	Veshje dhe këpucë	2,4	1,6	0,3	1,3	-0,5	-0,6	-0,9	-0,2	-0,8	0,5	-0,5	-0,2	0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,1	0,4	1,0	1,3	0,0	-0,4	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1
5	Mobililje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,1	0,1	0,2	0,5	-0,1	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	-0,1	-0,6	0,2	0,1
6	Shëndeti	-0,1	0,0	0,4	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	-0,5	-0,3	0,0	0,0
7	Transporti	0,1	-0,3	1,3	-0,1	0,0	-0,1	0,1	0,2	0,4	0,6	0,5	0,3	0,2
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,2	0,2	0,0	0,4	0,0	-0,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	2,2	0,8	-1,5	0,5	0,2	0,4	1,0	1,7	0,2	0,0	-0,5	0,4	2,0
10	Shërbimi arsimor	0,2	0,3	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,0	0,4	0,2	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,1	-0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,2	-0,2	0,0	-0,1	0,0	-0,1

SHPJEGIME METODOLOGJIKE

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2016.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Kjo listë nuk ka ndryshime me vitin e kaluar, shporta përbëhet nga 332 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.